

RREGULLORE
E MONITORIMIT DHE MBIKËQYRJES
NË BURSËN SHQIPTARE TË TITUJVE ALSE

Miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Bursës ALSE nr. 18, datë 25.05.2018

TABELA PËRMBLEDHËSE

KAPITULLI I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME	3
NENI 1 OBJEKTI I RREGULLORES	3
NENI 2 QËLLIMI I RREGULLORES	3
NENI 3 BAZA LIGJORE	3
NENI 4 PËRKUFIZIME	3
KAPITULLI II: KONCEPTET E MONITORIMIT DHE MBIKËQYRJES.....	4
NENI 5 NIVELET E MBIKËQYRJES DHE MONITORIMIT NË BURSËN ALSE	4
NENI 6 PARIMI I MBIKËQYRJES DHE MONITORIMIT	4
NENI 7 PERSONAT PËRGJEGJËS PËR MBIKËQYRJEN DHE MONITORIMIN	4
KAPITULLI III: MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E ANËTARIT/BROKERIT	5
NENI 8 PANDASHMËRIA E PËRGJEGJËSISË MES ANËTARIT DHE BROKERIT TË TIJ.....	5
NENI 9 MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E ANËTARËVE TË BURSËS ALSE	5
NENI10 DETYRIMET E BROKERAVE TË ANËTARIT TË BURSËS ALSE	5
NENI 11 INFORMACIONI I PRIVILEGJUAR (INSIDER INFORMATION)	6
NENI 12 KUFIZIMET E BROKERIT TË ANËTARIT TË BURSËS ALSE ME KLIENTËT E TIJ	6
NENI 13 MONITORIMI I ANËTARIT/BROKERIT	6
NENI 14 MBIKËQYRJA E ANËTARIT/BROKERIT	7
KAPITULLI IV: MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E TREGUT NË ALSE	7
NENI 15 FUSHA E ZBATIMIT TË MONITORIMIT DHE MBIKËQYRJES SË TREGUT.....	7
NENI 16 PRAKTIKA TË DYSHUARA PËR PASTRIM PARASH APO FINANCIM TERRORIZMI	8
NENI 17 MONITORIMI I TREGUT	8
NENI 18 MBIKËQYRJA E TREGUT	9
NENI 19 E DREJTA E BURSËS ALSE PËR MBIKËQYRJE SHITESË NDAJ ANËTARIT/BROKERIT	9
NENI 20 DETYRIMI I ANËTARIT/BROKERIT PËR TË BASHKËPUNUAR	10
KAPITULLI V: MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E EMETUESVE TË LISTUAR/KUOTUAR NË ALSE.....	10
NENI 21 DETYRIMET E EMETUESIT	10
NENI 22 MONITORIMI I EMETUESVE TË LISTUAR/KUOTUAR	10
NENI 23 MBIKËQYRJA E KOMPANIVE TË LISTUARA	11
KAPITULLI VI: MBIKËQYRJA NË NIVEL VENDIMMARRËS.....	11
NENI 24 KOMPETENCAT E DREJTORIT EKZEKUTIV.....	11
NENI 25 KOMPETENCAT E KËSHILLIT MBIKËQYRËS	12
KAPITULLI VII: PROÇEDIMI NË RAST SHKELJE	12
NENI 26 E DREJTA E BURSËS ALSE PËR TË APLIKUAR PENALITETE DHE GJOBA.....	12
NENI 27 PROÇEDIMI NË RAST SHKELJE	12
NENI 28 E DREJTA PËR T'U ANKIMUAR NË AMF.....	13
NENI 29 Mbledhja, administrimi, dokumentimi dhe ruajtja e komunikimit rreth veprimeve të strukturave të Bursës ALSE për monitorimin dhe mbikëqyrjen.....	13
NENI 30 HYRJA NË FUQI	13

KAPITULLI I: DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti i Rregullores

Kjo rregullore ka për qëllim të krijojë kushtet për një proces të drejtë, transparent, të vazhdueshëm, të verifikueshëm dhe efikas të tregtimit të instrumentave financiarë në Bursën Shqiptare të Titujve ALSE nëpërmjet mbikëqyrjes efikase dhe monitorimit të vazhdueshëm të tregut dhe pjesëmarrësve të tregut.

Neni 2

Qëllimi i Rregullores

- Të përcaktojë rregullat dhe veprimet e mbikëqyrjes dhe monitorimit të tregut dhe pjesëmarrësve të tregut;
- Të përcaktojë sjelljet etike ndërmjet Anëtarëve të Bursës ALSE dhe klientëve të tyre;
- Të identifikojë, përcaktojë dhe marrë masa në lidhje me shkeljet dhe veprimet jo etike të Anëtarëve të ALSE lidhur me tregun dhe pjesëmarrësit e tregut;
- Të identifikojë, përcaktojë dhe marrë masa në lidhje me abuzimet dhe manipulimet e tregut;
- Të parandalojë shpërndarjen dhe abuzimin me informacionet e brendshme dhe konfidenciale që mund të ketë çdo person i lidhur me Bursën ALSE;
- Të mbikëqyrë dhe monitorojë shoqëritë e listuara dhe të kuotuar.

Neni 3

Baza Ligjore

Hartimi i kësaj rregullore bazohet në:

- Ligjin për "Titujt", nr. 9879, datë 21.2.2008, Republika e Shqipërisë;
- Rregulloren e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nr.115, datë 11. 09 . 2008 "Mbi Përmbajtjen dhe Mënyrën e Mbajtjes së Librit të Porosive dhe Librit të Transaksioneve;
- Rregulloren e Bursës Shqiptare të Titujve ALSE;

Neni 4

Përkufizime

Në kuptim të kësaj Rregulloreje:

- a) **Abuzim i Tregut** – konsiderohen ato veprime të disa investitorëve të cilët krijojnë disavantazhe në treg kundrejt investitorëve të tjerë;
- b) **AMF** – Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, është autoriteti përgjegjës për rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregut të Titujve në Republikën e Shqipërisë;
- c) **Anëtar** – në bazë të Rregullores së ALSE Anëtar është çdo Shoqëri Komisionere, aplikuese për t'u Anëtarësuar në ALSE dhe Anëtarësimi i së cilës nuk ka përfunduar ende;
- d) **Baza Rregullatore** – nënkupton tërësinë e ligjeve dhe rregulloreve të zbatueshme në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë kuadrin rregullativ në fuqi të Bursës ALSE.
- e) **Broker** – është një person fizik i licensuar nga AMF në bazë të ligjit nr. 9879, datë 21.2.2008 "Për Titujt", i cili punësohet nga një Anëtar dhe autorizohet prej tij për të vepruar si personi përgjegjës për tregtimin në emër të Anëtarit që e ka caktuar dhe të klientëve të këtij Anëtar;
- f) **Bursa ALSE** – është Bursa Shqiptare e Titujve ALSE;
- g) **Emetues** – nënkupton çdo person juridik, titujt e të cilit (ose çdo klasë titujsh) janë pranuar ose i nënshtrohen një aplikimi për t'u pranuar në listim dhe/ose kuotim në Bursën ALSE;
- h) **Informacion i Privilegjuar (Insider Information)** – janë të gjitha faktet, të cilat nuk janë bërë të njohura publikisht dhe të cilat i përkasin një ose më shumë emetuesve të titujve ose janë të lidhura me vetë titujt dhe të cilat, nëse do të viheshin në dispozicion të publikut, mund të ndikonin në tregun e Bursës ose në çmimin e titujve.

- i) **Informacion që ka Ndikim mbi Çmimin (*PriceSensitiveInformation*)** – konsiderohet çdo informacion i papublikuar dhe i pa-aksesueshëm nga publiku që ka lidhje të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me veprimtarinë e një shoqërie të listuar në bursë dhe që publikimi i të cilit, do të ndikonte vendimmarrjen e investitorëve për të blerë apo shitur, e për rrjedhojë edhe çmimin e titullit në fjalë.
- j) **Libri Qendror i Urdhrave (COB)** – nënkupton Librin e Urdhrave i Sistemit ETS, në të cilin regjistrohen të gjithë urdhrat dhe ndryshimet deri në përputhjen, skadimin ose tërheqjen e tyre;
- k) **Manipulim Tregu** – konsiderohet një përpjekje e qëllimshme për të ndërhyrë në funksionimin e lirë dhe të drejtë të tregut duke krijuar trend fiktiv rritës/rënës, lidhur me çmimet e tregut;
- l) **Mbikëqyrje** – konsiderohet procesi i kontrollit nga Bursa ALSE në mënyrë të përhershme ose rast pas rasti i të gjithë veprimeve dhe veprimtarisë së tregut dhe/ose pjesëmarrësve të tregut;
- m) **Monitorim** – konsiderohet procesi i kontrollit nga Bursa ALSE në mënyrë periodike të vazhdueshme të të gjithë veprimeve dhe veprimtarisë së tregut dhe/ose pjesëmarrësve të tregut;
- n) **Pjesëmarrës Tregu** – konsiderohen Anëtarët, Brokerat, klientët e Anëtarëve, shoqëritë e listuara si dhe të gjithë operatorët që në mënyrë drejtpërdrejtë apo të tërthortë kanë lidhje me veprimtarinë e përditshme të tregtimit të titujve në Bursën ALSE;
- o) **Sistemi Elektronik i Tregtimit (ETS)** – është platforma elektronike e tregtimit që kryen tregtimin (përputhjen e urdhrave) e të gjithë titujve të kuotuar në ALSE, siç parashikohet në Rregulloren e ALSE;

KAPITULLI II: KONCEPTET E MONITORIMIT DHE MBIKËQYRJES

Neni 5

Nivelet e Mbikëqyrjes dhe Monitorimit në Bursën ALSE

Aktiviteti i pjesëmarrësve të tregut në Bursën ALSE mbikëqyret dhe monitorohet me tre nivele:

- 1) **Niveli Operacional**, i cili ka të bëjë me procesin e monitorimit në mënyrë periodike të tregut dhe operatorëve të tregut;
- 2) **Niveli i Menaxhimit të Rrezikut**, i cili ka të bëjë me procesin e mbikëqyrjes periodike dhe rast pas rasti të tregut dhe operatorëve të tregut, duke përfshirë edhe masat përkatëse në rast mosmarrëveshje, problemesh, shkeljesh apo vepimesh jo etike;
- 3) **Niveli Vendimarrës**, i cili ka të bëjë me marrjen e vendimeve në rastin e veprimeve që pasojnë procesin e mbikëqyrjes dhe monitorimit.

Neni 6

Parimi i Mbikëqyrjes dhe Monitorimit

Mbikëqyrja dhe monitorimi i tregut dhe pjesëmarrësve të tregut në Bursën ALSE realizohet sipas parimit të “katër syve”. Sipas këtij parimi, secili prej veprimeve të mbikëqyrjes dhe monitorimit të ndjekura në çdo nivel të mbikëqyrjes të parashikuar në nenin 5 të kësaj rregulloreje realizohet duke kontrolluar nivelin paraardhës.

Neni 7

Personat Përgjegjës për Mbikëqyrjen dhe Monitorimin

Personat përgjegjës për mbikëqyrjen dhe monitorimin e tregut dhe pjesëmarrësve të tregut në Bursën ALSE do të jetë si vijon:

- 1) për *Nivelin Operacional*, sipas rastit janë:
 - specialisti i Anëtarësimit dhe Listimit
 - specialisti i Tregtimit, Klerimit dhe Shlyerjes
- 2) për *Nivelin e Menaxhimit të Rrezikut*, do të jetë Njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut,
- 3) për *Nivelin Vendimarrës*, sipas rastit janë:
 - Drejtori Ekzekutiv
 - Këshilli Mbikëqyrës

KAPITULLI III: MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E ANËTARIT/BROKERIT

Neni 8

Pandashmëria e përgjegjësisë mes Anëtarit dhe Brokerit të tij

Anëtari është përgjegjës para AMF-së, Bursës ALSE dhe pjesëmarrësve të tjerë të tregut në lidhje me të gjitha veprimet dhe mosveprimet e tij si person juridik dhe të brokerit të tij si person fizik.

Brokëri vepron vetëm në emër e për llogari të Anëtarit që përfaqëson në ALSE, si dhe në emër e për llogari të klientëve të Anëtarit që ai përfaqëson.

Klientët e brokerit janë klientët e Anëtarit. Brokëri nuk mund të veprojë me klientë që nuk kanë marrëdhënie kontraktuale me Anëtarin që brokëri përfaqëson në ALSE.

Neni 9

Monitorimi dhe Mbiqëqyrja e Anëtarëve të Bursës ALSE

Bursa ALSE monitoron në mënyrë periodike dhe mbiqëqyr rregullisht plotësimin e detyrimeve të Anëtarëve bazuar në Rregulloren e Bursës Shqiptare të Titujve ALSE. Bursa ALSE monitoron dhe mbiqëqyr nëse Anëtari:

- 1) zbaton Rregulloren e Bursës ALSE, siç mund të ndryshohet herë pas here;
- 2) përmbush detyrimet e tij sipas Marrëveshjes së Pranimit për Anëtarësim dhe sipas çdo marrëveshjeje tjetër, në të cilën ALSE dhe Anëtari janë palë;
- 3) paguan tarifat dhe detyrimet e vendosura nga ALSE në përputhje me kushtet e vendosura prej saj e që u janë komunikuar paraprakisht Anëtarëve;
- 4) vepron në pajtim me kërkesat teknike të Sistemin ETS dhe të çdo sistemi ose rrjeti tjetër të teknologjisë së informacionit që përdoret nga ALSE, siç përcaktohet në marrëveshjen përkatëse;
- 5) informon ALSE për çdo veprim korporativ ose veprime të tjera me tituj që mund të shkaktojnë moszbatimin e Bazës Rregullatore nga Anëtari.
- 6) informon ALSE me shkrim në të gjitha rastet kur brokëri fizik i tij largohet, pezullohet nga puna apo i hiqet e drejta për të ushtruar veprimtarinë normale nga vetë Anëtari, apo nga autoriteti përgjegjës.
- 7) zbaton Bazën Rregullatore në fuqi për Parandalimin e Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit. Secili nga Anëtarët duhet t'i vendosë në dispozicion Bursës ALSE të gjithë informacionet e nevojshme që nevojiten për zbatimin e këtyre procedurave.

Mbiqëqyrja e Anëtarëve të ALSE mund të bëhet në distancë (Off-Site) dhe pranë zyrave të Anëtarit (On-Site)

Neni 10

Detyrimet e Brokerave të Anëtarit të Bursës ALSE

- 1) Brokerat e Anëtarit të ALSE janë të detyruar të mos i vendosin në dispozicion palëve të treta dhe t'i mbrojnë elementët e identifikimit të tyre personal për të aksesuar sistemin ETS.
- 2) Brokerat e Anëtarit të ALSE janë të detyruar të rregjistrojnë menjëherë urdhrat e klientëve të tyre në Librin Qëndror të Urdhrave (COB) të Sistemit ETS, në përputhje me Bazën Rregullatore në fuqi;
- 3) Pasi këto urdhëra janë rregjistruar në COB, Brokerat e Anëtarit të ALSE mund të kryejnë ndryshime në to vetëm me dëshirën e klientit dhe vetëm për përfitimin e tij;
- 4) Çdo Broker i Anëtarit të ALSE nuk mund të vendosë në Sistemin ETS, të ndryshojë apo të fshijë nga sistemi urdhra pa marrë dakordësinë e klientit të tij, vetëm në qoftë se klienti ka autorizuar në mënyrë të përcaktuar Brokërin e Anëtarit të kryejë hedhje urdhrash apo fshirje të tyre;
- 5) Çdo Anëtar duhet të rregjistrojë urdhrat në librin e tij të urdhrave, në bazë të Nenit 8 të Rregullores së AMF mbi Përmbajtjen dhe Mënyrën e Mbajtjes së Librit të Porosive dhe Librit të Transaksioneve;
- 6) Kur investojnë për llogari të klientëve të tyre, Brokerat e Anëtarëve të ALSE duhet të sillen në mënyrë të drejtë, transparente në mirëbesim dhe në interes të plotë të klientit të tyre;

- 7) Secili nga Anëtarët dhe Brokerat e Bursës ALSE është i detyruar t'i trajtojë klientët e tij në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese;

Neni 11

Informacioni i Privilegjuar (Insider Information)

- 1) Në momentin kur pranon të ekzekutojë një urdhër nga klienti i tij, nëse e sheh të arsyeshme, Anëtari i Bursës ALSE mund t'i kërkojë klientit të tij të shprehë me shkrim nëse është në zotërim të ndonjë "Informacioni të Privilegjuar";
- 2) Brokëri i Anëtarit në Bursën ALSE nuk duhet të blejë ose të mbajë për llogari të Anëtarit dhe/apo klientit, një titull të përftuar në bazë të një informacioni të brendshëm dhe të privilegjuar;
- 3) Brokëri i Anëtarit të ALSE nuk duhet të blejë/shesë për llogari të vetë Anëtarit një titull të urdhëruar më parë për t'u blerë/shitur nga klienti i tij dhe më pas t'ia shesë/blejë atij me një çmim më të lartë/ulët;
- 4) Personi që ka akses në informacione të privileguara nuk duhet t'ia zbulojë këtë informacion personave të tretë;
- 5) Personi që ka akses në informacione të privileguara nuk duhet të përdorë këtë informacion për të rekomanduar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të tërthortë palët e treta për të kryer transaksione në një titull të caktuar.

Neni 12

Kufizimet e Brokerit të Anëtarit të Bursës ALSE me Klientët e Tij

Një Broker i Anëtarit të Bursës ALSE nuk duhet:

- 1) Të ekzekutojë transaksione për llogari të klientëve me qëllim rritjen e përfitimeve të Anëtarit për të cilën ai punon;
- 2) Të kryejë veprime në Bursën ALSE për llogari të tij ose për llogari të të tretëve duke përdorur paratë e një klienti të tij;
- 3) Të shesë për llogari të tij ose për llogari të klientit të tij, tituj të cilët nuk i zotëron asnjëra nga palët e sipër përmëndura;
- 4) T'i japë prioritet urdhrave që bëhen për llogari të Anëtarit përpara urdhrave të klientëve në shkelje me parimet e prioritetit të çmimit dhe të kohës,
- 5) T'i japë prioritet urdhrave që bëhen për llogari të një klienti të Anëtarit përpara urdhrave të klienti tjetër në shkelje me parimet e prioritetit të çmimit dhe të kohës,
- 6) Të ekzekutojë një urdhër me terma më të favorshëm sesa ato të përcaktuara nga klienti i tij për qëllim përfitimi vetjak;
- 7) Të kryejë veprime të cilat janë në dëm të interesit të klientit dhe të integritetit të tregut të Bursës ALSE.

Neni 13

Monitorimi i Anëtarit/Brokerit

Specialisti i Anëtarësimit në ALSE është personi përgjegjës për monitorimin e aktivitetit të Anëtarit/Brokerit të ALSE, dhe raporton tek njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Riskut në ALSE.

Specialisti i Anëtarësimit, ndër të tjera, ka për detyrë:

- 1) të monitorojë rregullisht dhe rast pas rasti, përputhshmërinë e të gjithë veprimeve të Anëtarëve, Brokerave me Bazën Rregullatore në fuqi që ka të bëjë me Anëtarësimin gjatë veprimtarisë së tyre në oraret zyrtare të tregtimit në bursë (on-exchange), dhe oraret e tregtimit jashtë burse (off-exchange).
- 2) të monitorojë në mënyrë periodike zbatueshmërinë e detyrimeve që kanë Anëtarët/Brokerat e ALSE sipas Kapitullit III dhe IV të kësaj rregulloreje.
- 3) të administrojë çdo ankesë që vjen nga pjesëmarrësit e tregut, kundrejt njëri-tjetrit apo kundrejt Bursës ALSE, në lidhje me veprimtarinë e Anëtarëve/Brokerave të Bursës ALSE.
- 4) të raportojë me shkrim te njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut pranë ALSE në lidhje me çdo veprim të administruar gjatë procesit të monitorimit, si dhe në lidhje me çdo praktikë të dyshimtë, apo

shkelje të konstatuar nga veprimet dhe/apo mosveprimet e Anëtarit/Brokerit në veprimtarinë e tij të përditshme.

Neni 14

Mbikëqyrja e Anëtarit/Brokerit

Njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut është përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së Anëtarit/Brokerit të ALSE, dhe raporton te Drejtori Ekzekutiv.

Njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut, ndër të tjera, ka për detyrë:

- 1) të mbikëqyrë rregullisht dhe rast pas rasti, kur e shikon të arsyeshme, përputhshmërinë e të gjithë veprimeve të Anëtarëve/Brokerave me Bazën Rregullatore në fuqi, që ka të bëjë me Anëtarësimin gjatë periudhës që janë Anëtarë/Broker të ALSE.
- 2) të mbikëqyrë në mënyrë periodike zbatueshmërinë e detyrimeve që kanë Anëtarët/Brokerat e ALSE-s, sipas Kapitullit III dhe IV të kësaj rregulloreje.
- 3) të administrojë informacionet që vijnë nga Specialisti i Anëtarësimit të ALSE, në lidhje me shkeljet e dyshuara të Anëtarit/Brokerit.
- 4) të marrë masat e nevojshme për zgjidhjen e çdo problemi, qartësimin e çdo praktike të dyshimtë apo penalizimin e çdo shkelje të konstatuar nga veprimet dhe/apo mosveprimet e Anëtarit/Brokerit në veprimtarinë e tij të përditshme.
- 5) të raportojë me shkrim te Drejtori Ekzekutiv i ALSE në lidhje me çdo masë të ndërmarrë sipas këtij neni, duke dhënë argumentet ligjore dhe operacionale sipas rastit.
- 6) të raportojë te Drejtori Ekzekutiv i ALSE në lidhje me çdo problem, praktikë të dyshimtë apo shkelje të konstatuar nga veprimet dhe/apo mosveprimet e Anëtarit/Brokerit në veprimtarinë e tij të përditshme, e cila ka mbetur e pazgjidhur.
- 7) i propozon Drejtorit Ekzekutiv të ALSE veprimet e mundshme që kërkojnë vendimmarrje në Nivel Vendimmarrës, me qëllim zgjidhjen e problematikës së parashikuar në pikën 6 të këtij neni.

KAPITULLI IV: MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E TREGUT NË ALSE

Neni 15

Fusha e zbatimit të Monitorimit dhe Mbikëqyrjes së Tregut

Monitorimi dhe mbikëqyrja e tregut në Bursën ALSE fokusohet, por pa u kufizuar, në parandalimin, identifikimin, përcaktimin dhe marrjen e masave kundër praktikave të paligjshme të tregtimit nga Anëtarët, Brokerat e Anëtarëve dhe klientët e tyre.

Për qëllim të kësaj rregulloreje, konsiderohen të paligjshme të gjithë praktikatat e parashikuara në Ligjin "Për Titujt" dhe Rregulloren e Bursës ALSE (kapitulli 8) që kanë të bëjmë me manipulimin e tregut (market abuse), por pa u kufizuar me to, si dhe praktikatat në vijim:

- 1) Praktika të dyshuara për Pastrim Parash, apo Financim Terrorizmi,
- 2) Çdo veprim tjetër që konsiderohet nga ALSE se cënon integritetin e tregut dhe dëmton mekanizmin e konkurrencës së lirë e të ndershme në tregtimin e titujve në ALSE.

Neni 16

Praktika të dyshuara për Pastrim Parash apo Financim Terrorizmi

Praktika të dyshuara për Pastrim Parash apo Financim Terrorizmi janë ato të përcaktuara në Bazën Rregullatore në fuqi.

Bursa ALSE rregullon procesin e menaxhimit të praktikave të dyshuara për Pastrim Parash apo Financim Terrorizmi, sipas procedurave të përcaktuara në një rregullore të veçantë.

Neni 17

Monitorimi i Tregut

Specialisti i Tregtimit, Klerimit dhe Shlyerjes në ALSE është personi përgjegjës për monitorimin e tregut, dhe raporton me shkrim te njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Riskut në ALSE.

Monitorimi i transaksioneve në ALSE nga specialisti i Tregtimit, Klerimit dhe Shlyerjes synon zbulimin e sinjaleve të abuzimit me tregun. Monitorimi zbatohet kryesisht mbi bazën e vlerësimit të rrezikut për të gjithë tregjet e ALSE, duke pasur parasysh kryesisht kriteret e mëposhtme:

- a) Vëllimet e tregtimit dhe likuiditetin e një titulli.
- b) Segmentin e tregut të ALSE ku është i listuar dhe kuotohet një titull.
- c) Gjetjet e mëparshme të procedurave të monitorimit.
- d) Ndryshimet e rregullave që lidhen me tregtimin në ALSE dhe me abuzimin e tregut.
- e) Klasifikimi i një titulli në një prej metodave të tregtimit (e vazhdueshme; ankand).
- f) Llojin e titullit të tregtuar.
- g) Nivelin e shpërndarjes së pronësisë tek investitorët të cilët nuk janë të mirë-informuar.
- h) Udhëzime të hollësishme nga AMF, nëse ka.

Specialisti i Tregtimit, Klerimit dhe Shlyerjes, ndër të tjera, ka për detyrë:

- 1) të monitorojë në mënyrë periodike veprimtarinë e Anëtarëve/Brokerave në lidhje me procesin e tregtimit, klerimit dhe shlyerjes së transaksioneve në tituj në përputhje me Bazën Rregullatore në fuqi.
- 2) të monitorojë në mënyrë periodike zbatueshmërinë e detyrimeve që kanë Anëtarët/Brokerat e ALSE sipas Kapitullit III dhe IV të kësaj rregulloreje.
- 3) të monitorojë rregullisht dhe rast pas rasti, të gjithë veprimet e Brokerave të Anëtarëve të Bursës ALSE në Sistemin ETS gjatë orareve zyrtare të tregtimit në bursë (on-exchange), dhe orareve të tregtimit jashtë burse (off-exchange). Për të realizuar këtë detyrë, specialisti i Tregtimit, Klerimit dhe Shlyerjes përdor platformën elektronike të tregtimit (Surveillance Workstation), pjesë e Sistemit ETS.
- 4) të administrojë çdo ankesë që vjen nga pjesëmarrësit e tregut, kundrejt njëri-tjetrit apo kundrejt Bursës ALSE, në lidhje me aktivitetin e Anëtarëve/Brokerave të Bursës ALSE.
- 5) të administrojë çdo mosmarrëveshje mes pjesëmarrësve të tregut.
- 6) të raportojë me shkrim te njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut pranë ALSE në lidhje me çdo veprim të administruar gjatë procesit të monitorimit të tregut si dhe në lidhje me çdo praktikë të dyshimtë, apo shkelje të konstatuar nga veprimet dhe/apo mosveprimet e Anëtarit/Brokerit në veprimtarinë e tij të përditshme të tregtimit, klerimit dhe shlyerjes së titujve.

Mënyra e administrit të ankesave, mosmarrëveshjeve dhe praktikave të dyshimta do të përcaktohet në udhëzim të veçantë.

Neni 18

Mbikëqyrja e Tregut

Njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut është përgjegjëse për mbikëqyrjen e veprimtarisë së tregtimit, klerimit dhe shlyerjes së titujve për Anëtarin/Brokerin e ALSE, dhe raporton te Drejtori Ekzekutiv.

Njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut, ndër të tjera, ka për detyrë:

- 1) të mbikëqyrë rregullisht dhe rast pas rasti kur e shikon të arsyeshme, të gjithë veprimet e Anëtarëve/Brokerave të Bursës ALSE gjatë procesit të tregtimit në Sistemin ETS gjatë orareve zyrtare të tregtimit në bursë (on-exchange), dhe orareve të tregtimit jashtë burse (off-exchange). Për të realizuar këtë detyrë, specialisti i Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut nëpërmjet sistemit elektronik të mbikëqyrjes (Surveillance Workstation) identifikon çdo rast të dyshimtë që bie ndesh me rregulloren e Bursës ALSE dhe me çdo rregullore apo udhëzim tjetër të nxjerrë nga kjo e fundit.
- 2) të mbikëqyrë në mënyrë periodike zbatueshmërinë e detyrimeve që kanë Anëtarët/Brokerat e ALSE sipas Kapitullit III dhe IV të kësaj rregulloreje.
- 3) të shqyrtojë me vëmendje të gjitha rastet kur kërkohet nga palët ndryshimi i të dhënave të një transaksioni apo fshirja e tij dhe jep vendimin e tij për këtë modifikim, nëse e gjykon të arsyeshme e të bazuar në prova.
- 4) të administrojë informacionet që vijnë nga Specialisti i Tregtimit, Klerimit dhe Shlyerjes së ALSE në lidhje me shkeljet e dyshuara të Anëtarit/Brokerit.
- 5) të marrë masat e nevojshme për zgjidhjen e çdo problemi, qartësimin e çdo praktike të dyshimtë, apo penalizimin e çdo shkelje të konstatuar nga veprimet dhe/apo mosveprimet e Anëtarit/Brokerit në veprimtarinë e tij të përditshme.
- 6) bazuar në Rregulloren e Bursës ALSE, të marrë sipas rastit masat e menjëhershme deri në pritjen e një vendimi nga organet vendimmarrëse të Bursës ALSE, kur identifikohen shkelje duke:
 - i. pezulluar për një kohë të pacaktuar tregtimin e një titulli,
 - ii. pezulluar Brokerin e Anëtarit për një kohë të pacaktuar.
 - iii. pezulluar Anëtarin për një kohë të pacaktuar.
- 7) të raportojë me shkrim te Drejtori Ekzekutiv i ALSE në lidhje me çdo masë të ndërmarrë sipas këtij neni, duke dhënë argumentat ligjore dhe operacionale sipas rastit.
- 8) të raportojë te Drejtori Ekzekutiv i ALSE në lidhje me çdo problem, praktikë të dyshimtë, apo shkelje të konstatuar nga veprimet dhe/apo mosveprimet e Anëtarit/Brokerit në veprimtarinë e tij të përditshme, e cila ka mbetur e pazgjidhur.
- 9) i propozon Drejtorit Ekzekutiv veprimet e mundshme që kërkojnë vendimmarrje në Nivel Vendimmarrës, me qëllim zgjidhjen e problematikave të parashikuar në pikën 8 të këtij neni.

Koha dhe procedura më e detajuar për kryerjen e veprimeve nga njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut përcaktohet në një udhëzim të veçantë.

Neni 19

E drejta e Bursës ALSE për Mbikëqyrje Shtesë ndaj Anëtarit/Brokerit

Sa herë që e shikon të nevojshme, Bursa ALSE me nismë të saj apo kërkesë nga palë të treta, mund të kryejë kontrole të dokumentacioneve të regjistrimit të urdhrave, mbajtjen e të dhënave të klientëve dhe kryerjen e kontroleve pranë zyrave të Anëtarit përkatës.

Bursa ALSE do të njoftojë Anëtarin për arsyet e kryerjes së kësaj mbikëqyrjeje 48 orë përpara se të paraqitet pranë zyrave të tij.

Në raste të veçanta kur Bursa ALSE konsideron se informacioni nga pika 2 i këtij neni mund të parandalojë realizimin, apo rezultatet e mbikëqyrjes dhe monitorimit, nuk do ta informojë Anëtarin.

Të gjithë informacionet dhe dokumentat e mbledhura gjatë kontrollit të ushtruar nga Bursa ALSE nuk mund t'i shpërndahen personave të tretë, përveçse kur e detyron kuadri ligjor në fuqi dhe/ose kërkohen me shkrim nga Autoritetet Kompetente.

Neni 20

Detyrimi i Anëtarit/Brokerit për të bashkëpunuar

- 1) Në rast të realizimit të mbikëqyrjes dhe monitorimit, Anëtari/Brokeri i ALSE është i detyruar të bashkëpunojë dhe t'i mundësojë punonjësve të autorizuar të Bursës ALSE të gjithë dokumentacionin e nevojshëm që kërkohet nga ky i fundit.
- 2) Të japë akses në çdo kohë në të gjitha mjediset ku Anëtari vepron dhe mban dokumentacionin;
- 3) Të lejojë kontrollin dhe nëse është e nevojshme fotokopjimin ose skanimin e të gjithë dokumenteve që lidhen me veprimet në Bursë si dhe marrjen e një kopje të çdo materiali, që është subjekt i kontrollit që mund të përdoret si evidencë.

KAPITULLI V: MONITORIMI DHE MBIKËQYRJA E EMETUESVE TË LISTUAR/KUOTUAR NË ALSE

Neni 21

Detyrimet e Emetuesit

Emetuesi i titujve në Bursën ALSE duhet:

- 1) të emetojë tituj në përputhje me kërkesat e Bazës Rregullatore në fuqi;
- 2) të përmbushë të gjithë kriteret cilësore dhe sasiore të listimit në listën zyrtare të ALSE dhe të kuotimit në Tregun Hyrës;
- 3) të përmbushë çdo detyrim financiar kundrejt ALSE;
- 4) gjatë aplikimit për listim/kuotim të informojë për kohën dhe botimin e prospektit, pas miratimit nga AMF;
- 5) të trajtojë në mënyrë të barabartë mbajtësit e titujve të së njëjtës klasë, të emetuar prej tij;
- 6) t'i raportojë sipas rastit, në mënyrë periodike, apo të menjëhershme, Bursës ALSE dhe publikut:
 - a) çdo informacion lidhur me veprimtarinë e emetuesit që ka ndikim të drejtpërdrejtë ose të tërthortë mbi çmimin e titujve të saj të listuara në ALSE (*price sensitive information*);
 - b) çdo informacion financiar, duke përfshirë por pa u kufizuar me pasqyrat financiare, në përputhje të plotë me kriteret specifike të vendosura nga Bursa ALSE.
 - c) çdo informacion tjetër të kërkuar nga Bursa ALSE, që konsiderohet me rëndësi për mbarëvajtjen dhe qëndrueshmërinë tregut apo menaxhimin e rrezikut.
- 7) Të informojë ALSE për veprimet korporative të parashikuara në Rregulloren e Bursës ALSE lidhur me titujt e tij të pranuar në listim/kuotim, në mënyrë që të lehtësohet funksionimi i paanshëm, i rregullt dhe efikas i tregut.

Neni 22

Monitorimi i Emetuesve të Listuar/Kuotuar

Specialisti i Listimit në ALSE është personi përgjegjës për monitorimin e Emetuesve të listuar/kuotuar, dhe raporton te njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Riskut në ALSE.

Specialisti i Listimit në ALSE monitoron nëse Emetuesit e listuar/kuotuar:

- 1) kanë përmbushur detyrimet për listimin/kuotimin që i janë vendosur nga Rregullorja e Bursës ALSE;
- 2) kanë përmbushur kriteret cilësore dhe sasiore për listimin/kuotimin në Bursën ALSE;
- 3) ndikojnë negativisht në reputacionin e ALSE-s, për shkak të zhvillimeve, ose fakteve të konstatuara;

- 4) raportojnë, sipas rastit, në mënyrë periodike apo të menjëhershme te Bursa ALSE dhe publiku informacionet e nevojshme për mirëfunksionimin e drejtë, të rregullt dhe efikas të tregut, investitorëve dhe publikut siç parashikohet në Kapitullin V të kësaj rregulloreje;
- 5) raportojnë te Bursa ALSE informacionet lidhur me veprimet korporative, ose veprime të tjera me tituj, të cilët ndikojnë në mirëfunksionimin e tregut, siç parashikohet në Rregulloren e Bursës ALSE;

Neni 23

Mbikëqyrja e Kompanive të Listuara

Njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut është përgjegjëse për mbikëqyrjen e Emetuesve të listuar/kuotuar në ALSE, dhe raporton te Drejtori Ekzekutiv.

Njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut, ndër të tjera, ka për detyrë:

- 1) të mbikëqyrë rregullisht dhe rast pas rasti kur e shikon të arsyeshme, përputhshmërinë e të gjithë veprimeve të Emetuesve të listuar/kuotuar me Bazën Rregullore në fuqi që ka të bëjë me emetimin, listimin dhe kuotimin e titujve në tregjet e Bursës ALSE.
- 2) të mbikëqyrë në mënyrë periodike zbatueshmërinë e detyrimeve që kanë Emetuesit e listuar/kuotuar sipas Kapitullit V të kësaj rregulloreje.
- 3) të administrojë informacionet që vijnë nga Specialisti i Listimit të ALSE në lidhje me shkeljet e dyshuara të Emetuesve të listuar/kuotuar.
- 4) të marrë masat e nevojshme për zgjidhjen e çdo problemi, qartësimin e çdo praktike të dyshimtë, apo penalizimin e çdo shkelje të konstatuar nga veprimet dhe/apo mosveprimet e Emetuesit në veprimtarinë e tij të përditshme.
- 5) të raportojë me shkrim te Drejtori Ekzekutiv i ALSE në lidhje me çdo masë të ndërmarrë sipas këtij neni, duke dhënë argumentet ligjore dhe operationale sipas rastit.
- 6) të raportojë te Drejtori Ekzekutiv i ALSE në lidhje me çdo problem, praktikë të dyshimtë, apo shkelje të konstatuar nga veprimet dhe/apo mosveprimet e Emetuesit në veprimtarinë e tij të përditshme.
- 7) t'i propozojë Drejtorit Ekzekutiv veprimet e mundshme që kërkojnë vendimmarrje në Nivel Vendimmarrës, me qëllim zgjidhjen e problematikës së parashikuar në pikën 6 të këtij neni.

Koha dhe procedura për kryerjen e veprimeve nga Njësia e Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut përcaktohen në një udhëzim të veçantë.

KAPITULLI VI: MBIKËQYRJA NË NIVEL VENDIMMARRËS

Neni 24

Kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv

Drejtori Ekzekutivi ALSE mund të marrë masa të menjëhershme si më poshtë:

- 1) të pezullojë përkohësisht, por jo më shumë se dhjetë (10) ditë kalendarike, një titull nga listimi/kuotimi dhe informon menjëherë Këshillin Mbikëqyrës dhe AMF-në për veprimin e ndërmarrë dhe për masat e mëtejshme;
- 2) të pezullojë një broker përkohësisht, por jo më shumë se dhjetë (10) ditë kalendarike, nga tregtimi dhe të informojë menjëherë Këshillin Mbikëqyrës dhe AMF-në për masat e mëtejshme;
- 3) të pezullojë një Anëtar përkohësisht, por jo më shumë se dhjetë (10) ditë kalendarike, nga anëtarësimi dhe të informojë menjëherë Këshillin Mbikëqyrës dhe AMF-në për masat e mëtejshme;
- 4) të vendosë anulimin dhe/apo modifikimin e një transaksioni pas orarit zyrtar, që mund të jetë hedhur gabim nga Brokëri, me sugjerimin e specialistit të tregtimit, klerimit dhe shlyerjes si dhe të informojë menjëherë Këshillin Mbikëqyrës dhe AMF-në për vendimin e marrë,

- 5) të informojë menjëherë Këshillin Mbikëqyrës dhe AMF-në, në rast dyshimi të arsyeshëm të kryerjeve të veprës penale, në lidhje me tregun e titujve;
- 6) t'i raportojë menjëherë Këshillit Mbikëqyrës dhe AMF-së çdo veprim mbikëqyrës dhe monitorues, së bashku me veprimet e marra në çdo rast.
- 7) të informojë menjëherë AMF-në për vendimet e marra nga Këshilli i Mbikëqyrës mbi shkeljet e kryera nga Brokerat, Anëtarët dhe Emetuesit sipas nenit 25 të kësaj Rregulloreje.

Procedura se si do të merren masat e menjëhershme do të përcaktohen në një udhëzim të veçantë.

Neni 25

Kompetencat e Këshillit Mbikëqyrës

Me propozim të Drejtorit Ekzekutiv, Këshilli Mbikëqyrës i ALSE:

- 1) Pezullon një titull nga listimi/kuotimi për një afat të caktuar;
- 2) Pezullon një Broker fizik nga e drejta për të tregtuar në Sistemin ETS për një afat të caktuar;
- 3) Pezullon anëtarësimin e një anëtari për një afat të caktuar;
- 4) Heq përfundimisht një titull të listuar/kuotuar nga tregu i ALSE;
- 5) Heq përfundimisht të drejtën e një Brokeri fizik për të tregtuar në Sistemin ETS të ALSE;
- 6) Heq përfundimisht anëtarësimin e një Anëtari nga ALSE;
- 7) I propozon AMF-së heqjen e licensës së Brokerit fizik për ushtrimin e veprimtarisë në Republikën e Shqipërisë;
- 8) I propozon AMF-së heqjen e licensës së Anëtarit për ushtrimin e veprimtarisë në Republikën e Shqipërisë;
- 9) Në rast shkeljeje, vendos masa të tjera administrative për pjesëmarrësit e tregut, bazuar në bazën ligjore.

KAPITULLI VII: PROÇEDIMI NË RAST SHKELJE

Neni 26

E drejta e Bursës ALSE për të aplikuar Penalitete dhe Gjoha

Gjatë shqyrtimit të dokumentacioneve dhe çdo herë që verifikohet një shkelje e rregullave të Bursës ALSE, kjo e fundit do të vendosë penaltete dhe gjoha sipas rastit.

Masa, kohëzgjatja dhe vlera e këtyre penalteteve dhe/ose gjobave përcaktohet në një rregullore të veçantë të Bursës ALSE.

Neni 27

Proçedimi në rast shkelje

- 1) Nisja e proçedurave për marrjen e masave dhe aplikimin e penalteteve dhe gjobave do të fillojë me propozimin e Njesisë së Mbikëqyrjes dhe Menaxhimit të Rrezikut, Drejtorit Ekzekutiv të Bursës ALSE ose pjesëmarrësve të tregut;
- 2) Në rast të konstatimit të shkeljeve më të mëdha të Bazës Rregullatore, Drejtori Ekzekutiv i Bursës ALSE njofton menjëherë Këshillin Mbikëqyrës dhe AMF-në, si dhe mbledh menjëherë Këshillin Mbikëqyrës për proçedimin dhe vendosjen e masave kundër pjesëmarrësit të tregut, i cili prezumohet se ka kryer shkeljen;
- 3) Pasi Këshilli Mbikëqyrës përcakton se kemi të bëjmë me shkelje serioze të Bazës Rregullatore, merr vendim për nisjen e një proçedure më të zgjeruar, në të cilën i kërkohet pjesëmarrësit të tregut që prezumohet se ka kryer shkeljen, të sjellë faktet e nevojshme për shfajësimin dhe mbrojtjen e tij. Në lidhje me këtë proçes:

- a) Pjesëmarrësi i tregut njoftohet për datën dhe orën në të cilën duhet të paraqesë dokumentat e nevojshme justifikuese;
- b) Pjesëmarrësit të tregut do t'i jepet koha e nevojshme për të përgatitur mbrojtjen e tij, por jo më shumë se dhjetë (10) ditë kalendarike. Ai duhet ta paraqesë këtë të fundit jo më vonë se ditën e përcaktuar nga Këshilli Mbikëqyrës i ALSE;
- c) Këshilli Mbikëqyrës i ALSE pasi shqyrton të gjithë dokumentet e dërguara nga pjesëmarrësi i tregut merr masat e nevojshme bazuar në Rregulloren e ALSE dhe Rregulloren e Penaliteteve;
- d) Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës bëhet me shkrim dhe i dorëzohet pjesëmarrësit të tregut, brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit.

Neni 28

E drejta për t'u ankimuar në AMF

Në rast se pjesëmarrësit e tregut kundërshtojnë vendimet e mbikëqyrjes në nivel vendimmarrës të Bursës ALSE, kanë të drejtën e ankimit tek Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare sipas kriterëve të parashikuara nga Bazën Rregullatore në fuqi.

Neni 29

Mbledhja, administrimi, dokumentimi dhe ruajtja e komunikimit rreth veprimeve të strukturave të Bursës ALSE për monitorimin dhe mbikëqyrjen

Të gjithë strukturat e përcaktuara në nenin 5, për të gjitha komunikimet, veprimet, masat që ndërmarrin me subjektet e kësaj rregulloreje, si dhe midis vetë këtyre strukturave në lidhje me monitorimin dhe mbikëqyrjen sipas përcaktimeve në këtë rregullore, veprojnë si më poshtë:

- Komunikojnë në mënyrë të dokumentuar (shkresë, e-mail) dhe në kohën e duhur;
- Administrojnë dhe ruajnë të gjithë dokumentacionin që mbështet veprimet e kryera;
- Sigurojnë që mund ta disponojnë këtë informacion sa herë që kjo është e nevojshme në përputhje me Bazën Rregullatore në fuqi.

Neni 30

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Këshilli i Mbikëqyrjes së ALSE.

KRYETARI
HYSEN ÇELA